

# FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË SË VERIUT

PROPOZUES: Shërbimi profesional i Fondit

PËRGATITËS: Sektori për çështje financiare

RAPORTUES: Fatime nexhipi, drejtoreshë e Sektorit

## PLANI STRATEGJIK I FONDIT TË SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË SË VERIUT PËR PERIUDHËN 2023-2025

Në nazë të nënit 157 pika 16 të Ligjit të sigurimit pensional dhe invalidor ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr.98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 13/16, 27/16, 120/16, 132/16, 35/18, 220/18 dhe 245/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 180/19, 275/19, 31/20, 267/20 dhe 67/22) dhe nenit 33 të Statutit të Fondit të Sgurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë („Gazeta Zyrtare e RM" nr.174/2013), Këshilli drejtues i Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 31 gusht të vitit 2022 solli:

**PLANI STRATEGJIK  
I FONDIT TË SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË SË VERIUT PËR  
PERIUDHËN 2023 - 2025**

**Shkup, gusht viti 2022**

PLANI STRATEGJIK I FONDIT TË SIGURIMIT  
PENSIONAL DHE INVALIDOR I  
MAQEDONISË SË VERIUT PËR PERIUDHËN  
2023-2025

## 1. HYRJJE

Plani strategjik i Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut (2023-2025) është në përputhje me Ligjin e sigurimit pensional dhe invalidor dhe Planin vjetor dhe Programin për punën e Fondit të Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut.

Me Ligjin e sigurimit pensional dhe invalidor janë rregulluar të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor për të gjithë të siguruarit.

Çështjet administrative, financiare, profesionale dhe çështjet e tjera të të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë së Veriut i zbaton Shërbimi profesional i Fondit edhe atë, në Qendër, 20 filiale dhe 10 Ekspozitura.

Organet e Fondit janë Këshilli drejtues i Fondit dhe Drejtori i Fondit. Për punën e tij, Këshilli drejtues i Fondit është përgjegjës para Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, me çka, çdo vit dorëzon Raport vjetor për punën e Fondit.

Këshilli drejtues formon komisione të përhershme dhe të përkohshme dhe trupa të tjerë punues për ndjekjen e çështjeve të caktuara në zhvillimin dhe zbatimin e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor, zgjidhjen e të drejtave të të siguruarve dhe përfituesve të pensionit dhe shqyrtimin e çështjeve në fushëveprimin e Këshillit drejtues.

Kompetenca, përbërja, mënyra e punës dhe çështjet e tjera të punës së komisioneve si dhe trupave të tjerë punues të Këshillit drejtues përcaktohen me Rregulloren e Këshillit drejtues.

Drejtori udhëheq me Fondin dhe e përfaqëson atë para personave të tretë, ndërsa për punën e tij është përgjegjës para Këshillit drejtues të Fondit dhe para Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Drejtori propozon Programin dhe Planin për punë dhe ndërmerr masa për realizimin-zbatimin e tyre, organizon dhe siguron realizimin ligjor dhe efektiv të punëve në kuadër të fushëveprimit të Fondit , ndërsa Këshillit drejtues të Fondit rregullisht i dorëzon raporte dhe analiza mbi çështjet e të drejtës së sigurimit pensional dhe invalidor.

Drejtori i Fondit ka zëvendës. Zëvendësdrejtori e zëvendëson drejtorin e Fondit gjatë mungesës së tij dhe kryen detyra të tjera të përcaktuara me Statutin e Fondit.

Puna në Qendër të Fondit kryhet në kuadër të pesë sektorëve. Me sektorët udhëheqin drejtorët e sektorëve. Aktin mbi organizimin e punës dhe sistematizimin e vendeve të punës në Shërbimin profesional të Fondit e përfshin struktura organizative e cila tregon ndarjen e brendshme të punës dhe të marrëdhënieve ndërmjet sektorëve të veçantë. Detyrat, përgjegjësitë dhe lidhshmëria ndërmjet pozicioneve individuale të punës janë bazuar në strukturën organizative të Fondit.

## 2. ZHVILLIMI I PROCESIT MBI PLANIFIKIMIN STRATEGJIK

Me buxhetin e Fondit planifikohen dhe propozohen që shumat vjetore të të drejtës për shpenzim, për qëllime të caktuara dhe të drejtat e njejta për shpenzime janë kufizuar me realizimin e planit të të hyrave.

Fondi punon në përputhje me kufizimin e të drejtës së buxhetit për shpenzim dhe nuk ndërmerr për obligim të drejtën e caktuar mbi shpenzimet.

Buxhetin e Fondit e përcakton Këshilli drejtues i Fondit, ndërsa e miraton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut si pjesë përbërëse e Buxhetit të Vendit.

Procesi i Buxhetit përbëhet nga tri faza kryesore që realizohen në periudha të ndryshme kohore, edhe atë:

## Procesi i buxhetit

Gjatë përgatitjes së Buxhetit të Fondit merret parasysh politika makroekonomike në të cilën janë definuar prioritetet qeveritare, ndërsa janë përmbajtur edhe indikatorët makroekonomik për lëvizjen e punësimit dhe pagat që janë bazë për planifikimin e të hyrave dhe të dalave të Fondit.

Ministria e financave përgatit qarkoren Buxhetore në të cilën janë paraqitur udhëzimet kryesore për përgatitjen e Buxhetit të Fondit. Në bazë të qëllimeve të parapara në qarkore, Fondi përgatit buxhetin duke marr parasysh nivelin e arritur të të hyrave dhe të dalave si dhe dispozitat ligjore të sigurimit pensional dhe invalidor.

## Qarkorja buxhetore

Qarkorja buxhetore u dorëzohet të gjithë shfrytëzuesve buxhetor dhe fondeve dhe pas marrjes të së njëjtës në Fond fillon procesi i përgatitjes së Propozim- kërkesës buxhetore.

Pas miratimit të politikave makroekonomike dhe marrjes së qarkores Buxhetore fillojnë aktivitetet e Fondit për përgatitjen e Propozim - kërkesës buxhetore.

Ky proces i definon të hyrat dhe të dalat e Fondit për zbatimin e sigurimit pensional dhe invalidor dhe përfshin disa faza:

- Analiza e nivelit të arritur të të hyrave dhe të dalave dhe vlerësimet deri në fund të vitit;
- Vlerësimi i të hyrave të Fondit sipas llojit të të hyrave dhe llojit të të dalave.

Indikatorët makroekonomik për llogaritjen e kontributeve janë rritja e pagave dhe rritja e punësimit, ndërsa në pjesën e të dalave janë rritja e pagave dhe rritja e shpenzimeve për jetë dhe në bazë të këtyre parametrave përcaktohet përqindja e harmonizimit të pensioneve.

Propozim – buxheti i përgatitur i Fondit i dorëzohet Këshillit drejtues të Fondit për shqyrtim dhe miratim dhe nëse dalin aktivitete të reja ose përjashtim i disa aktiviteteve, bëhet korigjim, gjegjësisht harmonizim i Buxhetit. Buxheti i përcaktuar i dorëzohet Ministrisë së financave.

Nga momenti që do të kryhet harmonizimi i kërkesës buxhetore me propozim të Ministrisë së financave, Ministria e Financave ia dorëzon Buxhetin Fondit, si pjesë përbërëse e Buxhetit të Vendit, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## Zbatimi i buxhetit

Ky proces është zbatimi i Buxhetit sipas kufizimeve (limiteve) të përcaktuara të të drejtave buxhetore për shpenzim. Fondi nuk guxon të ndërmer obligime mbi të drejtat e përcaktuara për shpenzime në vitin për të cilin është sjell buxheti.

Gjatë përgatitjes së buxhetit shfrytëzohen programe me qëllim që të shfaqen financime të veçanta për aktivitete të caktuara ose për një grup të aktiviteteve.

Planifikimi i buxhetit përfshin vlerësime për tre vite me të cilat planifikohen të hyra dhe të dala globale, gjegjësisht paraqiten me më pak detaje.

**Vizioni** Vizioni i Fondit të Sigurimit Pensionsal dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut është që, në të ardhmen ai të përfaqësojë një institucion modern me administratë profesionale dhe kompetente që do të sigurojë një shërbim të mirë, të shpejtë, kualitativ dhe në kohë për klientët, që do të ketë bashkëpunim kualitativ me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe do të kryejë pagesë të rregullt dhe në kohë të pensioneve, në mbështetje të Ligjit të sigurimit pensionsal dhe invalidor si dhe në mbështetje të Ligjit të sigurimit të detyrueshëm pensionsal me financim kapital.

**Misioni** Misioni i Fondit të Sigurimit Pensionsal dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut është realizimi i vizionit nëpërmjet:

- Modernizimit të procesit për realizimin e të drejtave të sigurimit pensionsal dhe invalidor;
- Sistemit modern informatik i cili ofron mbrojtjen maksimale dhe sigurinë e të dhënave të të siguarve dhe të obliguarve dhe i cili në vazhdimësi përmirësohet në mbështetje me arritjet e fundit në teknologjinë e informatikës;
- Sigurimit të kushteve më moderne për jetesë në shtëpitë e shfrytëzuesve të pensionit;
- Ndjekjes dhe harmonizimit të sistemit pensionsal në kornizat ndërkombëtare;
- Shërbimit kompetent profesional dhe përmirësimit të vazhdueshëm të tij nëpërmjet organizimit dhe ndjekjes së trajnimeve;
- Përgjegjësisë shoqërore duke ju shpjeguar të siguarve mbi realizimin e të drejtave të SPI nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta dhe materialeve të shtypura informatike, pjesëmarrjes në aksionet për dhurimin e gjakut, ekologjike dhe aksione tjera, bashkëpunimit me lidhjet dhe shoqatat e pensionistëve dhe të tjera.

### **Qëllimet e përgjithshme**

1. Shërbime cilësore dhe në kohë të klientëve të cilët realizojnë të drejta të SPI-së;
2. Pagesë të rregullt, në kohë dhe të saktë të pensioneve në Vend dhe jashtë vendit në mbështetje të Ligjit të SPI-së dhe Ligjit të sigurimit të detyrueshëm pensionsal me financim kapital;
3. Ligjshmëri në punë dhe zbatimin e dispozitave materiale nëpërmjet revizionit të të gjitha aktvendimeve të sjella me të cilat përcaktohen të drejtat e SPI-së;
4. Bazë e saktë, kualitative dhe azhurnuese e të dhënave për të gjithë të siguarit, obliguesit për pagesën e kontributeve të sigurimit pensionsal dhe invalidor;

5. Shërbim profesional i ekspertëve dhe zhvillimi i tij i kontinuar profesional;
6. Përdorimi i sistemit modern të informatikës i cili ofron mbrojtjen maksimale të të dhënave të klientëve;
7. Sigurimi i kushteve optimale për jetesë në shtëpitë e përfituesve të pensionit;
8. Pjesëmarrja e Fondit të SPIMV-së në procesin e harmonizimit të dispozitave nga fusha e sigurimit social me të drejtë në Bashkimin Evropian dhe përforcimin e kapaciteteve të Fondit të SPIMV-së në koordinimin e sistemit të sigurimit social.

### ***Qëllimet specifike***

*Shërbime cilësore dhe në kohë të klientëve të cilët realizojnë të drejtat e SPI-së.*

1. Menaxhimi i sistemit për cilësinë e shërbimeve, proceseve dhe punonjësve në Fond	
Gjendja aktuale	Fillimi i implementimit të ISO 9001:2015 standardit
Gjendja e ardhshme	Mirëmbajtja e sistemit në menaxhimin e cilësisë, ISO 2001:2015 me kontrolle mbikqyrëse
Përgjegjës	Menaxher i cilësisë
2. Të dhënat e sakta, complete dhe azhurnuese të të siguruarve dhe obliguesve	
Gjendja aktuale	Përcaktimi i të dhënave të plota për të siguruarit dhe të obliguarit
Gjendja e ardhshme	Qasje elektronike falas deri tek të dhënat e evidentuara
Përgjegjës	Spektori për realizimin e të drejtave të SPI
3. Procesimi i plotë i lëndëve pensionale në mënyrë elektronike	
Gjendja aktuale	Përveç lëndëve elektronike, paralelisht përdoret edhe forma në letër
Gjendja e ardhshme	Përkrahje e plotë aplikuese e të gjitha të drejtave të SPI-së
Përgjegjës	Spektori për realizimin e të drejtave të SPI dhe Spektori i informatikës
4. Pagesa e mjeteve për Fond solidar	
Gjendja aktuale	Pagesë në kohë e mjeteve për fondin solidar
Gjendja e ardhshme	Përditësimi (sipas nevojës) aplikimi për pagesën e mjeteve për fond solidar sipas datës së kërkesës së paraqitur
Përgjegjës	Spektori për çështje financiare
5. Shkurtimi i afateve për realizimin e të drejtës së pensionit invalidor	
Gjendja aktuale	15 ditë nga dita e pranimit të kërkesës deri në paraqitjen në kontroll mjekësor
Gjendja e ardhshme	Shkurtimi i afatit, rrjedhimisht pas

	kompletimit të dokumentacionit
Përgjegjës	Sektori për realizimin e të drejtave të SPI
6. Intensifikimi dhe përparimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e SPI	
Gjendja aktuale	Pamundësi për realizimin e të drejtave të SPI për shkak mungesës së marrëveshjeve ndërkombëtare me disa vende
Gjendja e ardhshme	Iniciativë për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare për sigurim social për realizimin e të drejtave të SPI
Përgjegjës	Sektori për zbatimin e dispozitave të BE-së dhe marrëveshjeve ndërkombëtare për Sigurim social

#### 7. Marrëdhënie me publikun

Gjendja aktuale	Informimi i të siguarve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve tona në përgjithësi për qytetarët – pensionistët e ardhshëm përmes ueb faqes së Fondit, koll qendra dhe faqja e facebook. Fondi, ndër të tjera, i kushton vëmendje të veçantë afirmimit të tij dhe punës së mëparshme të Shërbimit për marrëdhënie me publikun. Kjo do të thotë se transparenca e institucionit do të vazhdojë edhe ndaj shfrytëzuesve të shërbimeve tona dhe në përgjithësi ndaj qytetarëve – pensionistëve të ardhshëm.
Gjendja e ardhshme	Informimi i të siguarve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve tona përmes faqes në fejsbuk, organizimit të forumeve publike me karakter shpjegues, pres konferenca për shtyp dhe informimeve për gazetarët, si dhe përmes publikimit të bashkëngjitjeve, teksteve të dedikuara dhe aktuale, njoftimeve dhe komenteve për afirmimin e punën e Shërbimit Profesional të Fondit, si dhe me qëllim të informimit për të gjitha ndryshimet në rregulloret ligjore dhe aktivitetet aktuale të Fondit në fushën e sigurimit pensional dhe invalidor.
Përgjegjës	Sektori për resurse njerëzore, juridike dhe punë të përgjithshme



- *Pagesë e rregullt, e saktë dhe në kohë e pensioneve në Vend dhe jashtë vendit në mbështetje të Ligjit të SPI-së dhe Ligjit të sigurimit të detyrueshëm pensional me financim kapital.*

<b>1. Përsosmëria e procesit për pagesën e pensioneve</b>	
Gjendja aktuale	Vërtetimet për jetë dorëzohen nga ana e shfrytëzuesve të pensionit dy herë në vit. Punë me dosjet financiare dhe dokumentacioni i marrë në formë letre (fizikisht lëviz lënda nga një punonjës në tjetër). Për shfrytëzuesit e pensionit, anëtarë në shtyllën e dytë, vërtetim mbi të dhënat për pagesë në formë letre
Gjendja e ardhshme	Shkëmbimi elektronik i të dhënave me vendet e ish republikave Jugosllave për shfrytëzuesit e pensionit të cilët pranojnë pension nga R.Maqedonisë së Veriut. Puna me dosje financiare dhe dokumentacioni i marrë në formë elektronike (dokumente të skanuara) Për shfrytëzuesit e pensionit anëtarë në shtyllën e dytë, vërtetim mbi të dhënat për pagesë në formë elektronike
Përgjegjës	Sektori për çështje financiare
<b>2. Pagesë e rregullt e pensioneve</b>	
Gjendja aktuale	Pagesa e pensioneve në RMV dhe shtetet e huaja bëhet brenda një periudhe të caktuar të muajit - rregullisht
Gjendja e ardhshme	Pagesa e harmonizimit të të ardhurave pensionale sipas vendimeve të Qeverisë së RMV-së
Përgjegjës	Sektori për çështje financiare
<b>3. Ndërprerja në kohë e pagesës së përfituesve të ndjerë të pensionit</b>	
Gjendja aktuale	Ndërprerja e pagesës së shfrytëzuesve të ndjerë të pensionit bëhet përmes njoftimit sipas Marrëveshjes për bashkëpunim me Drejtorinë për udhëheqjen e librave amë në formë elektronike.
Gjendja e ardhshme	Mundësia e lidhjes së marrëveshjeve për shkëmbim elektronik të të dhënave me të gjitha vendet ku paguhen pensionet për shfrytëzuesit e pensioneve
Përgjegjës	Sektori për çështje financiare dhe Sektori i informatikës
<b>4. Sistemi i kontrollit të brendshëm</b>	

Gjendja aktuale	Në FSPIMV është krijuar sistem i cili siguron funksionimin normal të menaxhimit dhe kontrollit financiar me mundësi përmirësimi në segmente të caktuara. Janë ndërmarrë politika dhe aktivitete adekuate kontrolli për miratimin dhe zbatimin e dokumenteve strategjike, akteve nënligjore dhe të brendshme, ISO standardet e menaxhimit të cilësisë për aktivitete të rëndësishme, delegimin e kompetencave, shpërndarjen e detyrave dhe përgjegjësi, kontrollet financiare, kontrollet në qasjen deri te resurset dhe sigurinë fizike të tyre, kontrollet e përgjithshme dhe aplikative në sistemin e IT-së, sistemin e komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit, mënyrën e planifikimit, kryerjes, njoftimit dhe monitorimit.
Gjendja e ardhshme	Të vlerësojë përshtatshmërinë, ekonominë, efektivitetin dhe efikasitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit për përcaktimin, vlerësimin dhe menaxhimin me rreziqet nga udhëheqësia në subjekt në lidhje me: respektimin e ligjeve, akteve nënligjore dhe akteve e marrëveshjeve të brendshme; besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operativ dhe sigurinë e pronës dhe informacionit. Zbatimi i revizioneve përgjithësisht rezulton me rekomandime për përmirësimin e sistemit të kontrolleve të brendshme dhe se vetëm me zbatim aktiv të këtyre kontrolleve nga ana e Udhëheqësisë është e mundur të arrihen efekte të matshme nga zbatimi i tyre. Për të shprehur vlerën e shtuar të matshme të revizionit të brendshëm, revizioni i brendshëm do të monitorojë jo vetëm nëse rekomandimet janë zbatuar apo jo, por edhe do të monitorojë efektet e zbatimit të rekomandimeve.
Përgjegjës	Seksioni për revizion të brendshëm
<b>5. Menaxhimi financiar</b>	
Gjendja aktuale	Menaxhimi me financat e Fondit në mbështetje të mjeteve të tij të disponueshme dhe udhëheqje racionale dhe ekonomike me të njëjtat.
Gjendja e ardhshme	Përparimi i menaxhimentit financiar me qëllim të shfrytëzimit efikas, efektiv dhe ekonomik të mjeteve të Fondit të SPIMV-së.
Përgjegjës	Sektori për çështje financiare

- *Ligjshmëri në punë dhe zbatimin e dispozitave materiale nëpërmjet revizionit të të gjitha aktvendimeve të sjella me të cilat përcaktohen të drejtat e SPI-së*

1. Kontrolli i plotë i ligjshmërisë të të gjitha aktvendimeve të sjella me të cilat përcaktohet e drejta e SPI-së	
Gjendja aktuale	Revizion i të gjitha aktvendimeve të sjella me të cilat përcaktohet e drejta për SPI. Revizioni është shfuqizuar me LSPI nga viti 2019, por Seksioni për rregullore kryen kontrollë përzgjedhje të rastësishme të lëndëve direkt në Filialet apo dosjet elektronike.
Gjendja e ardhshme	Për këtë është dhënë propozim në Iniciativën për ndryshim dhe plotësim të LSPI-së që të kthehet revizioni i të gjitha aktvendimeve me të cilat realizohet e drejta nga SPI.
Përgjegjës	Sektori për realizimin e të drejtave të SPI

- *Bazë e saktë, cilësore dhe azhurnuese e të dhënave për të gjithë të sigurvearit, të obliguarit për pagesën e kontributeve të sigurimit pensional dhe invalidor*

1. Të dhëna të saka, të plota dhe të përditësuara	
Gjendja aktuale	Të dhënat Fondi i merr në mënyrë elektronike nga institucionet kompetente dhe subjektet afariste
Gjendja e ardhshme	Shkallë më e lartë e shkëmbimit të të dhënave dhe sigurimi i harmonizimit me bazat e të dhënave me institucionet tjera kompetente
Përgjegjës	Sektori për realizimin e të drejtave të SPI

- *Shërbimi profesional dhe përsosmëria e tij e vazhdueshme profesionale dhe monitorimi i pagesave të pa baza të Fondit*

1. Kompletimi i Shërbimit profesional	
Gjendja aktuale	Mungesë e kuadrove profesionale që ndikojnë në cilësinë e shërbimeve
Gjendja e ardhshme	Trajnimi i punonjësve nga ana e kuadrove profesionale dhe nëpërmjet seminareve

Përgjegjës	Sektori për resurse njerëzore, juridike dhe punë të përgjithshme
<b>2. Pagesë cilësore, efikase dhe në kohë e kërkesave në bazë të dëmit</b>	
Gjendja aktuale	Përgatitje elektronike e llogaritjes në bazë të dëmit dhe dorëzimi deri te Shërbimi juridik për veprim të mëtutjeshëm
Gjendja e ardhshme	Lidhja e marrëveshjes për bashkëpunim me të gjitha institucionet të përfshiera për shkëmbimin e të dhënave në formë elektronike
Përgjegjës	Sektori për resurse njerëzore, juridike dhe punë të përgjithshme
<b>3 Profesionalizimi i Shërbimit profesional dhe Ekipit të menaxhimit në mbështetje me kërkesat moderne</b>	
Gjendja aktuale	Vijimi i trajnimeve të brendshme dhe të jashtme
Gjendja e ardhshme	Vijimi i seminareve të ndryshme dhe punëtorive që janë profesionale dhe të specializuara në aspektin e menaxhimit me resurset njerëzore
Përgjegjës	Sektori për resurse njerëzore, juridike dhe punë të përgjithshme, Sektori për Informatikë dhe Sektori për çështje financiare
<b>4. Sigurimi i kushteve moderne për punë</b>	
Gjendja aktuale	Kushtet pjesërisht të papërshtatshme të punës
Gjendja e ardhshme	Ndërmarrja e masave me qëllim që të rritet motivimi dhe kënaqësia e punonjësve me çka do të rritej produktiviteti i punës.
Përgjegjës	Sektori për resurse njerëzore, juridike dhe punë të përgjithshme.

- *Përdorimi i sistemit modern të Informatikës i cili siguron mbrojtjen maksimale të të dhënave të klientëve.*

<b>1. Mirëmbajtja dhe mbrojtja e plotë e sistemit të informatikës</b>	
Gjendja aktuale	Mirëmbajtje me resurset personale edhe nga firmat e jashtme
Gjendja e ardhshme	Ndjekja e trendeve botërore
Përgjegjës	Sektori për informatikë
<b>2. Zhvillimi i sistemeve të informatikës, përkatësisht kontinuitet i rritjes së efikasitetit të proceseve afariste</b>	

Gjendja aktuale	Automatizimi i proceseve afariste, ndjekja e zhvillimit të sektorit të IT- së dhe punët aktuale
Gjendja e ardhshme	Përkrahje proporcionale e sistemeve afariste për zbatimin efikas të proceseve afariste
Përgjegjës	Sektori i informatikës
<b>3. Përkrahje e sistemit për teknologjinë e informatikës</b>	
Gjendja aktuale	Mjete buxhetore personale.
Gjendja e ardhshme	Gjendja e ardhshme t'i përkushtohet resurseve të brendshme dhe punësimit të kuadrove të reja dhe rritja e buxhetit.
Përgjegjës	Sektori i informatikës

- *Sigurimi i kushteve optimale për jetesë në shtëpitë e përfituesve të pensionit.*

<b>1. Përpunimi i softuerit aplikativ për rangim elektronik dhe strehim në shtëpitë e pensionistëve</b>	
Gjendja aktuale	Rangimin dhe strehimin e kryen Komisioni nga shërbimet profesionale të Fondit
Gjendja e ardhshme	Me softuerin aplikativ do të eliminohet vendimmarrja e faktorit njeri për rangimin dhe strehimin në shtëpitë e pensionistëve.
Përgjegjës	Sektori për resurse njerëzore, juridike dhe punë të përgjithshme
<b>2. Renovimi i një pjese të shtëpive të pensionistëve që janë në gjendje të keqe për përmirësimin e kushteve për jetesë të shfrytëzuesve të pensionit</b>	
Gjendja aktuale	Një pjesë e shtëpive për jetesë është renovuar, ndërsa një pjesë nuk është renovuar për një periudhë më të gjatë dhe nuk kanë kushte për jetesë të gjithë shfrytëzuesit e pensionit të strehuar në to
Gjendja e ardhshme	Me renovimin e të gjitha shtëpive për jetesë do të sigurohen kushte të njëjta për të gjithë shfrytëzuesit e pensionit në shtëpitë.
Përgjegjës	Sektori për resurse njerëzore, juridike dhe punë të përgjithshme Seksioni për ekonomizim me pronën e Fondit

- *Pjesëmarrja e Fondit të SPIMV-së në procesin e harmonizimit të dispozitave nga fusha e sigurimit social me të drejtë të Bashkimit Evropian dhe përforcimi i kapaciteteve të Fondit të SPIMV-së në koordinim të sistemeve të sigurisë sociale.*

1. Plotësimi i standardeve të BE-së	
Gjendja aktuale	Pjesëmarrja e Fondit të SPIMV-së në procesin e harmonizimit të dispozitave nga fusha e sigurimit social me të drejtë të Bashkimit evropian dhe përforcimi i kapaciteteve të Fondit të SPIMV-së në koordinim të sistemeve të sigurisë sociale.
Gjendja e ardhshme	Pjesëmarrja e punonjësve të Fondit të SPIMV-së në projektin INPP “Përforcimi i kapaciteteve për zbatimin efektiv të të drejtës së BE-së në fushën e lëvizjes së lirë të punonjësve, nga janari i vitit 2019.
Përgjegjës	Spektori për zbatimin e dispozitave të BE-së dhe marrëveshjeve ndërkombëtare për sigurim social
2. Bashkëpunim me fondet e pensioneve kombëtare të huaja	
Gjendja aktuale	Gjatë zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare për sigurim social nga ana e të dyja palëve kontraktuese, nënshkruese të marrëveshjes respektohen parimet e trajtimit të barabartë, përcaktimi i legjislacionit i cili do të zbatohet, ruajtja e të drejtave të arritura dhe pagesa (eksport) e pensioneve (beneficione).
Gjendja e ardhshme	Iniciativë për lidhjen e marrëveshjeve të reja për sigurim social, ndryshimet dhe plotësimet eventuale të marrëveshjeve të lidhura, marrëveshjet administrative dhe formularët dy gjuhësor.
Përgjegjës	Spektori për zbatimin e dispozitave të BE-së dhe marrëveshjeve ndërkombëtare për sigurim social.

**PLANI STRATEGJIK I FONDIT TË SPIMV-së**  
**2023 – 2025**

**VIZIONI**

Vizioni i Fondit të Sgurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë së Veriut është që në të ardhmen ai të përfaqësojë një institucion modern me një administratë profesionale dhe kompetente i cili do të sigurojë një shërbim të mirë, të shpejtë, cilësor dhe në kohë për klientët dhe do të ketë bashkëpunim cilësor me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare dhe do të kryejë pagesë të rregullt dhe në kohë të pensioneve

**MISIONI**

1. Shërbime cilësore dhe të shpejta të klientëve për realizimin e të drejtës të SPI-së.
2. Pagesë të rregullt, në kohë dhe të saktë të pensioneve në Vend dhe jashtë vendit në mbështetje të Ligjit të SPI-së dhe Ligjit të sigurimit të detyrueshëm pensional me financim kapital.
3. Ligjshmëri në punë dhe zbatimin e dispozitave materiale nëpërmjet një revizioni të të gjitha aktvendimeve të sjella me të cilat përcaktohen të drejtat e SPI-së.
4. Bazë të saktë, cilësore dhe azhurnuese të të dhënave për të gjithë të siguruarit - obligues për pagesën e kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor.
5. Shërbimi profesional cilësor dhe përsosmëria e tij e vazhdueshme profesionale
6. Shfrytëzimi i sistemit modern informatik i cili siguron mbrojtjen maksimale të të dhënave të klientëve.
7. Sigurimi i kushteve optimale për jetesë në shtëpitë e përfituesve të pensionit.
8. Pjesëmarrja e Fondit të SPIMV-së në procesin e harmonizimit të dispozitave nga fusha e sigurimit social me të drejtë të Unionit evropian dhe përforcimi i kapaciteteve të Fondit të SPIMV-së në koordinim të sistemeve të sigurisë sociale.

Supozime

Indikatorë

Zhvillimi i  
proceseve

Vlerat e  
Fondit

Të dalat e planifikuara të Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut për periudhën 2023-2025

<i>Përshkrimi i të dalave</i>	<i>Viti 2023</i>	<i>Viti 2024</i>	<i>Viti 2025</i>
Gjithsej pensione	<b>73.172,82</b>	<b>76.608,13</b>	<b>78.271,16</b>
Fondet pensionale private	11.818,64	13.080,57	14.405,21
Kompensime	100,00	100,00	100,00
Kontribut për shëndetësi	9.512,47	9.959,06	10.175,25
Shërim në banjë dhe transport	0,00	0,00	0,00
Paga dhe kompensime	293,00	298,00	301,21
Të dalat të tjera	160,00	150,00	150,00
Shpenzime kapitale	30,00	40,00	40,00
Punë ndërtimtarie	30,00	30,00	30,00
Blerja e një automjeti	2,00	2,00	2,00
<i>Gjithsej të dala</i>	<b>95.118,93</b>	<b>100.267,75</b>	<b>103.474,83</b>

Indikatorë

Përfitues të pensionit në fund të vitit	Numri i shfrytëzuesve
Viti 2023	345 245 shfrytëzues
Viti 2024	349 043 shfrytëzues
Viti 2025	353 022 shfrytëzues

Numri i të punësuarve në Fondine SPIMV-së	
Viti 2023	603 punonjës
Viti 2024	613 punonjës
Viti 2025	623 punonjës



## SWOT ANALIZË (Strengths, Weaknesses, Opportunities and Treats)

SWOT apo analizë e mundësive, anëve të dobëta, mundësive dhe kërcënimeve na mundëson të perceptojmë ndikimin e faktorëve të brendshëm në Fond.

### Përparësitë e FSPIMV-së janë:

- ✚ Servisim i suksesshëm i shërbimeve ndaj të siguarve dhe shfrytëzuesve të së drejtës të SPI-së
- ✚ Implementim i standardit ISO 9001:2015
- ✚ Shumicë e punonjësve me përvojë dhe kompetent
- ✚ Infrastrukturë e IT-së dhe e proceseve afariste të automatizuara
- ✚ Procedurë e përcaktuar dhe e definuar me kontrolle të mira të proceseve;
- ✚ Akte ligjore (rregullore);
- ✚ Shkëmbim elektronik i të dhënave me institucionet e tjera;
- ✚ Dorëzim elektronik i kërkesës për pension;
- ✚ Monitorim elektronik i stazhit të sigurimit;
- ✚ Përmirësim i vazhdueshëm i sistemit për matjen e kënaqësisë së shfrytëzuesve të shërbimit;
- ✚ Angazhimi i punonjësve në kryerjen me cilësi të lartë dhe në kohë të detyrave dhe obligimeve të punës;
- ✚ Gatishmëri për reagim të shpejtë dhe ndryshime në rast të situatave të paparashikuara.

### Anët e dobëta të cilat perceptohen në FSPIMV janë:

- ✚ Mungesa e resurseve njerëzore në sektore të caktuara veçanërisht në nga informatika dhe profili mjekësor;
- ✚ Pozicione drejtuese të paplotësuara (udhëheqës të seksioneve) që shkakton pamundësinë e delegimit të autorizimeve dhe përgjegjësisve për aktivitete të caktuara në funksionimin e Fondit;
- ✚ Matja dhe normalizimi i punës së çdo punonjësi apo seksioni;
- ✚ Mungesa e trajnimeve, që rezulton një pjesë e kuadrit të jetë joprofesional dhe i paarsimuar sipas specifikave të veprimtarisë së Fondit;
- ✚ Ekzistenca e punonjësve të painteresuar dhe të pamotivuar, si rezultat i pagave të ulëta dhe mbingarkesa me detyra pune (shpërndarje e pabartë e punës) sipas ekzekutuesve;
- ✚ Një pjesë e filialeve dhe ekspoziturave kanë kushte të këqija pune për shkak të mungesës së mjeteve për mirëmbajtje investuese;
- ✚ Mosrespektimi i afateve të punës;
- ✚ Kënaqësia e punonjësve nuk matet;
- ✚ Numri i pamjaftueshëm i trajnimeve të nevojshme brenda dhe jashtë vendit për ngritjen e punonjësve.

### Mundësitë për përmirësimin e gjendjes aktuale të Fondit janë:

- ✚ Rishpërndarja adekuatë e punonjësve në vendet përkatëse për të cilat ata janë të kualifikuar në mënyrë që ata të mund të japin një kontribut më të madh;
- ✚ Përmirësimi dhe përsosshmëria e punonjësve përmes trajnimeve gjenerike dhe të specializuara brenda dhe jashtë vendit;
- ✚ Avancimi i proceseve me ndihmën e IT-së;
- ✚ Thjeshtësimi i procedurave në sportel (reduktimi i hapave që duhet të bëjnë shfrytëzuesit e shërbimeve për të përfunduar punën- “gjithçka në një vend”);
- ✚ Shkëmbimi i të dhënave elektronike në nivel ndërkombëtar;
- ✚ Shërbime të reja për shfrytëzuesit e shërbimeve të Fondit të SPIMV-së;
- ✚ Gjetja e burimeve të reja të financimit;
- ✚ Mbështetje më e madhe nga institucionet tjera (MPPS, Ministria e Financave, MSHIA etj.);
- ✚ Shpërndarje e barabartë e lëndëve sipas filialeve.

### Rreziqet (kërcënimet) për funksionimin e rregullt të Fondit janë:

- ✚ Zgjidhjet ligjore që vështirësojnë proceset e realizimit të të drejtave nga SPI;
- ✚ Ndryshimet shpeshta të rregulloreve ligjore dhe nënligjore që kanë ndikim në punën e Fondit të SPIMV-së;
- ✚ Mungesa e një analize financiare (implikacionet financiare në Fondin e SPIMV-së) gjatë miratimit të legjislacionit që ndikon në punën e institucionit;
- ✚ Mospranimi i shënimeve nga Fondi i SPIMV-së me rastin e miratimit të aktvendimeve ligjore që janë me ndikim;
- ✚ Dokumentacioni i pavlefshëm (për stazhin, dokumentacionin mjekësor dhe çdo gjë tjetër që ndikon në realizimin e të drejtës nga SPI);
- ✚ Shuma të pashpërndara për kontributin e SPI;
- ✚ Varësia nga buxheti i RMV-së;
- ✚ Mungesa e personelit si pasojë e pengesave ligjore;
- ✚ Emigrimi i popullsisë së aftë për punë;
- ✚ Dalja e kuadrit profesional në institucione tjera, pensionimi dhe plotësimi i parakohshëm i vendeve të punës me punonjës të rinj që do të marrin përsipër njohuritë dhe përvojën e atyre që largohen;
- ✚ Situatat e paparashikuara me virusin COVID-19.

## Strengths (Përparësitë)

- ✚ Servisim i suksesshëm i shërbimeve ndaj të siguarve dhe shfrytëzuesve të së drejtës të SPI-së;
- ✚ Implementim i standardit ISO 9001:2015;
- ✚ Shumicë e punonjësve me përvojë dhe kompetent;
- ✚ Infrastrukturë e IT-së dhe e proceseve afariste të automatizuara;
- ✚ Procedurë e përcaktuar dhe e definuara me kontrolle të mira të proceseve;
- ✚ Akte ligjore (rregullore);
- ✚ Shkëmbim elektronik i të dhënave me institucione të tjera;
- ✚ Dorëzim elektronik i kërkesës për pension;
- ✚ Monitorim elektronik i stazhit të sigurimit;
- ✚ Përmirësim i vazhdueshëm i sistemit për matjen e kënaqësisë së shfrytëzuesve të shërbimit;
- ✚ Angazhimi i punonjësve në kryerjen me cilësi të lartë dhe në kohë të detyrave dhe obligimeve të punës;
- ✚ Gatishmëri për reagim të shpejtë dhe ndryshime në rast të situatave të paparashikuara.

## Weaknesses (Dobësitë)

- ✚ Mungesa e resurseve njerëzore në sektore të caktuara veçanërisht në nga informatika dhe profili mjekësor;
- ✚ Pozicione drejtuese të paplotësuara (udhëheqës të seksioneve) që shkakton pamundësinë e delegimit të autorizimeve dhe përgjegjësive për aktivitete të caktuara në funksionimin e Fondit;
- ✚ Matja dhe normalizimi i punës së çdo punonjësi apo seksioni;
- ✚ Mungesa e trajnimeve, që rezulton një pjesë e kuadrit të jetë joprofesional dhe i paarsimuar sipas specifikave të veprimtarisë së Fondit;
- ✚ Ekzistenca e punonjësve të paimentuar dhe të pamotivuar, si rezultat i pagave të ulëta dhe mbingarkesa me detyra pune (shpërndarje e pabartë e punës) sipas ekzekutuesve;
- ✚ Një pjesë e filialeve dhe ekspoziturave kanë kushte të këqija pune për hskak të mungesës së mjeteve për mirëmbajtje investuese;
- ✚ Mosrespektimi i afateve të punës;
- ✚ Kënaqësia e punonjësve nuk matet;
- ✚ Numri i pamjaftueshëm i trajnimeve të nevojshme brenda dhe jashtë vendit për ngritjen e punonjësve.

Opportunities (Mundësitë)	Threats (Rreziqet (kërcënimet))
<ul style="list-style-type: none"> <li>✚ Rishpërndarja adekuata e punonjësve në vendet përkatëse për të cilat ata janë të kualifikuar në mënyrë që ata të mund të japin një kontribut më të madh;</li> <li>✚ Përmirësimi dhe përsosshmëria e punonjësve përmes trajnimeve gjenerike dhe të specializuara brenda dhe jashtë vendit;</li> <li>✚ Avancimi i proceseve me ndihmën e IT-së;</li> <li>✚ Thjeshtësimi i procedurave në sportel (reduktimi i hapave që duhet të bëjnë shfrytëzuesit e shërbimeve për të përfunduar punën- “gjithçka në një vend”);</li> <li>✚ Shkëmbimi i të dhënave elektronike në nivel ndërkombëtar;</li> <li>✚ Shërbime të reja për shfrytëzuesit e shërbimeve të Fondit të SPIMV-së;</li> <li>✚ Gjetja e burimeve të reja të financimit;</li> <li>✚ Mbështetje më e madhe nga institucionet tjera (MPPS, Ministria e Financave, MSHIA etj.);</li> <li>✚ Shpërndarje e barabartë e lëndëve sipas filialeve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✚ Zgjidhjet ligjore që vështirësojnë proceset e realizimit të të drejtave nga SPI;</li> <li>✚ Ndryshimet shpesh të rregulloreve ligjore dhe nënligjore që kanë ndikim në punën e Fondit të SPIMV-së;</li> <li>✚ Mungesa e një analize financiare (implikacionet financiare në Fondin e SPIMV-së) gjatë miratimit të legjislacionit që ndikon në punën e institucionit;</li> <li>✚ Mospranimi i shënimeve nga Fondi i SPIMV-së me rastin e miratimit të aktvendimeve ligjore që janë me ndikim;</li> <li>✚ Dokumentacioni i pavlefshëm (për stazhin, dokumentacionin mjekësor dhe çdo gjë tjetër që ndikon në realizimin e të drejtës nga SPI);</li> <li>✚ Shuma të pashpërndara për kontributin e SPI;</li> <li>✚ Varësia nga buxheti i RMV-së;</li> <li>✚ Mungesa e personelit si pasojë e pengesave ligjore;</li> <li>✚ Emigrimi i popullsisë së aftë për punë;</li> <li>✚ Dalja e kuadrit profesional në institucionet e tjera dhe pensionimi dhe plotësimi i parakohshëm i vendeve të punës me punonjës të rinj që do të marrin përsipër njohuritë dhe përvojën e atyre që largohen;</li> <li>✚ Situatat e paparashikuara me virusin COVID-19.</li> </ul>

Duke vendosur kontekstin, pra analizën swot, Fondi i SPIMV-së përcakton parametrat e brendshëm që merren parasysh gjatë punës.

Konteksti i brendshëm është mjedisi i brendshëm në të cilin organizata synon të arrijë qëllimet e saj.

Konteksti i brendshëm janë faktorët që në kuadër të Fondit të SPIMV-së mund të ndikojnë në përmbushjen e qëllimeve.

Nr.02-3942/1  
Shkup, 31 gusht viti 2022

**KËSHILLI DREJTUES**  
Kryetar,  
Boro Varoshlija